



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) 06/2021, nenit 53 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës DL nr.1546-2/22 të datës 25.03.2022 të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Me këtë Vendim, anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-354/02-0014599/22 i datës 28 shkurt 2022 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.prot.01-354/02-0087371/18 i miratuar nga Kuvendi i Komunës më 02 nëntor 2018.


Neni 2

Anulimi sipas nenit 1, bëhet për shkak se Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës përmes Shkresës DL nr.1546-2/22 të datës 25.03.2022, ka vlerësuar se akti është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, duke theksuar se hyrja e Vendimit është bazuar vetëm në Ligjin nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, dhe Ligjin nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, konkretisht duke potencuar se Ligji nr.06/L-092 nuk rregullon çështjen e ridestinimit të objekteve, nuk është bazuar në Ligjin nr.04/L-174 për planifikim hapësinorë si dhe nuk është i bazuar as në dokumentet e planifikimit hapësinorë dhe dokumentet tjera sipas Ligjit të cekur.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës së Podujevës.

Nr.prot 01-354/02-0030741/22
Podujevë, datë, 29 prill 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha